

VENDIM
Nr.678, datë 16.10.2003

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE CIVILË, QË DALIN TË PAPUNË NGA REFORMA NË
SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8930, datë 25.7.2002 "Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë", të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit civilë, që, më datë 1.9.2003, mbetën të papunë nga reforma në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, të trajtohen financiarisht, për një periudhë 6-mujore, në masën 100 për qind të pagës bazë mujore dhe të shtesës për vjetërsi në punë, në çastin e shkëputjes së marrëdhënieve financiare.

2. Për punonjësit e trajtuar sipas pikës 1 të këtij vendimi të derdhen kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme, nga Buxheti i Shtetit në fondin e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.

3. Periudha e pagesës për këta persona të njihet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Kjo periudhë të shënohet në librezën e punës.

4. Të drejtën e trajtimit e kanë ata punonjës që kanë qenë të punësuar në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar pa ndërprerje, për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit e që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike si punëdhënës, punëmarrës ose të vetëpunësuar. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

5. Fondet financiare, të nevojshme për kryerjen e pagesave dhe për sigurimet e detyrueshme, në shumën 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekë, të përballohen nga Ministria e Mbrojtjes.

6. Caktimi, administrimi e pagimi i trajtimit dhe derdhja e kontributit të sigurimeve shoqërore të detyrueshme të këtyre punonjësve të bëhen nga Spitali Ushtarak Qendror Universitar.

7. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, nga zëri "Mallra e shërbime" t'i zbritet shuma prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, e cila të kalojë në zërin "Shpenzime për pagat", për përballimin e efekteve financiare për këtë vit.

8. Ngakohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.9.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano